



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 893/1 Prot

Tiranë, më 29/4 /2022

VENDIM

Nr. 11, datë 29.4.2022

PËR

MOSPRANIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 (a) (i) të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Znj. _____ (në vijim “ankuesja”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 893 Prot., datë 28.04.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në cilësinë e kërkueses, ankuesja, me e-mail-in datë 14.04.2022, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni *lidhur me çështjen e Ish Uzinës së Superfosfatit Kurbin, duke patur parasysh kohën e gjatë pa një përgjigje*.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, Komisioneri konstaton se ankesa është depozituar pranë Zyrës së Komisionerit me 2 (dy) ditë pune, përpara përfundimit të afatit të vendosur në dispozicion të Autoritetit Publik për kthimin e përgjigjes, në kundërshtim kjo me pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014

“Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI), në të cilën përcaktohet se: “1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe”.

Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 24 të LDI parashikohet se: “Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.”

Sa më sipër, rezulton se nuk është përmbushur detyrimi për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga kushtet formale të nevojshëm për marrjen në shqyrtim të ankesave. Mosrespektimi i afatit të ankimit, përbën shkak për mos pranimin e ankesës.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a), i) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Mospranimin e ankesës nr. 893 Prot., datë 28.04.2022, të znj. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 29.4 .2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

